



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "100%Design shpk" të datës 09.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Restaurimi dhe ndërtimi i Muzeut shtëpi shkolla - Herticët" me nr. të prokurimit 616-25-7033-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "100%Design shpk" të datës 09.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Restaurimi dhe ndërtimi i Muzeut shtëpi shkolla - Herticët" me nr. të prokurimit 616-25-7033-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "100%Design shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 09.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Restaurimi dhe ndërtimi i Muzeut shtëpi shkolla - Herticët" me nr. të prokurimit 616-25-7033-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Sipas nenit 7.3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, kriteret për kualifikimin duhet të jenë **proporionale dhe të ndërlidhura drejtpërdrejtë me objektin e kontratës**. Kriteri për "Piktor të licensuar" nuk lidhet drejtpërdrejt me aktivitetin kryesor të kontratës që ka të bëjë me (Punime ndërtimore, punë gërmimit, betonit, armatures, murshimit, termoizolimit, hidroizolimit, punë të elektrikes, punë të ujësjellësit, kanalizimit, instalime të ngrohjes etj).

Pas analizimit me kujdes të kërkesës përkatëse të DT në kuptim të nenit 7 të LPP, është konstatuar se kërkesa për piktor të licensuar me A3-10 nuk është fare i nevojshëm as në aspektin ligjor por as në aspektin logjik dhe logjistik. Prandaj pretendimet janë gjetur si të bazuara ashtu që kërkesa për "piktor të licensuar me A3-10" largohet nga DT.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.09.2025

Visar SHEHU


Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.